

# ePeriodik

## PUBLIKIM MUJOR, Numri 158, Korrik 2022

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Qershor 2022
- Ecuria e tregut me pakicë të titujve të Qeverisë, Janar–Qershor 2022

### Zhvillime të tjera

- Edukimi financiar për tregjet nën mbikëqyrje, AMF bashkëpunon me grupin Intesa Sanpaolo
- Konsultim publik për projektregulloren “Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara”.
- AMF asiston Komisionin e Letrave me Vlerë të Ukrainës në procesin e përafrimit ligjor me kuadrin e Bashkimit Evropian

### Publikime Profesionale

- Global Risk Regulator: BE vendos kriptot brenda perimetrit rregullator
- IOSCO Publikohet “*Crypto-Asset Roadmap for 2022-2023*”

### Informacione Ndërkombëtare

Bullgari  
Rumani

Kroaci  
Serbi

Maqedoni e Veriut  
Tendencat e tregut evropian

Republika Çeke

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar–Qershor 2022


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit përgjatë periudhës janar-qershor 2022 kapën vlerën 9,775 milionë lekë, ose 10.25% më shumë se në janar-qershor 2021. Gjatë periudhës janar-qershor 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 566,051 me një rritje prej 21.08% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.32% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.56%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.28% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 57.72% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-qershor 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,192 milionë lekë, ose 14.71% më pak se në periudhën janar-qershor 2021.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-qershor 2022 kapën vlerën 2,156 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 3.83% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Struktura e tregut të sigurimeve, Janar–Qershor 2022 (Në %)



Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-qershor 2022 kapën vlerën 2,156 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 3.83% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## Ecuria e Tregut me Pakicë të Titujve të Qeverisë, Janar – Qershor 2022

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për periudhën janar - qershor 2021, u dominua në masën 64.08% nga transaksione në instrumente afatgjatë (*obligacione*) dhe 35.92% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 72.03% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për periudhën janar – qershor 2022, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 58.83% dhe 28.15% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar – qershor 2022 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.10% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

### Transaksionet e grupeve B dhe C


Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar – qershor 2022, ka pasur një rritje prej 929 milionë lekë ose 64.02% krahasuar me janar – qershor 2021. Numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 19.01%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar – qershor 2022, ka pasur një rritje prej 437 milionë lekë ose 42.98%, ndërkohë pati gjithashtu rritje në numrin e transaksioneve në masën 14.38%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një rritje në vlerë absolute me rreth 1,366 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar – qershor 2021.

### Tregu i titujve të Qeverisë, Janar–Qershor 2022

(Në %)



Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar – qershor 2022 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.10% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

# ZHVILLIME TË TJERA

## Edukimi Financiar për Tregjet nën Mbikëqyrje, AMF bashkëpunon me Grupin Intesa Sanpaolo



6 korrik – Takim me grupin Intesa SanPaolo

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete, zhvilloi një takim me Kryetarin e Këshillit Drejtues të Grupit Intesa Sanpaolo, z. Gian Maria Gros-Pietro. Në këtë takim u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimit në funksion të nismave për edukimin financiar, hapësirat për ofrimin e shërbimeve dhe alternativave të reja të investimit për klientët, si edhe tendencat e fundit të tregjeve financiare duke shfrytëzuar inovacionin dhe teknologjinë.

Z. Mete u shpreh se krizat e njëpasnjëshme të viteve të fundit kanë shtuar nevojën për të ridimensionuar jo vetëm shoqëritë që operojnë në tregjet financiare, por edhe Autoritetet rregullatore. Edhe pse në përgjithësi tregjet financiare jobankare kanë shfaqur qëndrueshmëri ndaj ndikimeve të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, Autoriteti po vijon të monitorojë në vijimësi zhvillimet në këto tregje.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së u ndal te rëndësia e rritjes së edukimit financiar dhe nxitjes së përfshirjes financiare. Në këtë kuadër, eksperiencia e grupit Intesa Sanpaolo mund të jetë një vlerë e shtuar për një avancim cilësor të edukimit financiar në Shqipëri.

Kryetari i Këshillit Drejtues të Grupit Intesa Sanpaolo, z. Gian Maria Gros-Pietro parashtroi disa nga objektivat e grupit Intesa Sanpaolo për një përfshirje më të gjerë në Shqipëri, përmes ofrimit të shërbimeve të reja për klientët. Ai theksoi se nismat për edukimin financiar dhe rritjen e përfshirjes sociale kanë qënë në fokus të grupit Intesa Sanpaolo, i cili ka një eksperiencë të zgjeruar në përdorimin e teknologjisë dhe metodave të avancuara në këtë drejtim. Z. Gros-Pietro shprehu angazhim për të bashkëpunuar dhe ofruar ekspertizën e grupit në funksion të rritjes së njohurive për tregjet financiare edhe në Shqipëri.

Përfaqësuesit e grupit Intesa Sanpaolo vlerësuan rolin e Autoritetit në drejtim të modernizimit të kuadrit ligjor të tregjeve nën mbikëqyrje dhe përafrimit me direktivat evropiane, gjë që ka mundësuar zgjerimin dhe diversifikimin e shërbimeve që operatorët e tregut mund t'u ofrojnë klientëve.

Përfaqësuesit e grupit Intesa Sanpaolo vlerësuan rolin e Autoritetit në drejtim të modernizimit të kuadrit ligjor të tregjeve nën mbikëqyrje dhe përafrimit me direktivat evropiane.

## AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren "Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara"




Projektregullorja  
gjendet në

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=84>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka hartuar projektregulloren "Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara".

Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=84>

## AMF asiston Komisionin e Letrave me Vlerë të Ukrainës në procesin e përafrimit ligjor me kuadrin e Bashkimit Evropian



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së shprehu gadishmërinë e Autoritetit për të ofruar të gjithë asistencën e nevojshme për Komisionin e Letrave me Vlerë të Ukrainës.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete zhvilloi një takim online me Kryetarin e Komisionit të Letrave me Vlerë të Ukrainës, z. Ruslan Magomedov. Në fokus të takimit ishte bashkëpunimi në funksion të përafrimit të legjislacionit me Direktivat dhe kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian. Kjo edhe në dritën e zhvillimeve të fundit, ku Shqipëria hapi zyrtarisht negociatat e anëtarësimit, ndërsa Ukrainës iu dha statusi i vendit kandidat nga Komisioni Evropian. Takimi u zhvillua nën koordinimin e Bankës Botërore, e cila ka rekomanduar Shqipërinë për të dhënë eksperiencën e saj ndaj Ukrainës sa i përket procesit të përafrimit të legjislacionit me kuadrin e Bashkimit Evropian.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së shprehu gadishmërinë e Autoritetit për të ofruar të gjithë asistencën e nevojshme ndaj Komisionit të Letrave me Vlerë të Ukrainës.

Në cilësinë e negociatorit të kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, z. Mete parashtroi hapat e ndjekura deri tani nga Shqipëria në procesin e negociatave, si edhe e njohu Kryetarin e Komisionit të Letrave me Vlerë të Ukrainës, z. Magomedov, me një udhërrëfyes për hapat e nevojshme në funksion të përafrimit legjislativ dhe punës përgatitore në kuadër të negociatave të anëtarësimit. Me ndërmjetësimin e Bankës Botërore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të asistojë Komisionin e Letrave me Vlerë të Ukrainës në procesin e përafrimit legjislativ me *aquis* të BE-së.

Kryetari i Komisionit të Letrave me Vlerë të Ukrainës e falenderoi z. Mete për mbështetjen dhe frymën e bashkëpunimit, si edhe vlerësoi se progresi i bërë nga Shqipëria në procesin e negociatave dhe eksperiencën e Autoritetit me përafrimin legjislativ për tregjet nën mbikëqyrje, do t'i shërbejnë Ukrainës për të ecur më shpejt në rrugën e saj të integritimit evropian.

Në vitin 2020 u miratuan ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive. Shqipëria vlerësohet të ketë një kuadër ligjor të avancuar në këtë drejtim, të përafuar me direktivat evropiane. Në zbatim të ligjeve të reja, Autoriteti ka përfunduar me miratimin e rregulloreve për sipërmarrjet e investimeve kolektive, ndërsa është në fazën finale të hartimit dhe miratimit të pjesës së mbetur të akteve nënligjore për tregjet e kapitalit.

BE vendos kriptot brenda perimetrit rregullator

## Global Risk Regulator

A SERVICE FROM THE BANKER

Celsius blow-up  
How to improve crypto  
platforms



Home

Subjects

Regions

Blog

Video

Regions / Europe

## EU brings crypto into regulatory perimeter

Justin Pugsley | July 6, 2022



Crypto-assets, their issuers and crypto-asset service providers (CASP) have been pulled into an EU-wide regulatory framework for the first time following a provisional agreement between the European Council and the European Parliament announced on June 30.

Justin Pugsley

<https://www.globalriskregulator.com/Regions/Europe/EU-brings-crypto-into-regulatory-perimeter?ct=true>

Kripto asetet, emetuesit e tyre dhe ofruesit e shërbimeve të aseteve kripto (CASP) janë përfshirë brenda kuadrit rregullator në mbarë BE-në. Kjo është hera e parë që ndodh pas një marrëveshjeje të përkohshme midis Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian të shpallur më 30 qershor.



International Organization of Securities Commissions  
Organisation internationale des commissions de valeurs  
Organizaçao Internacional das Comissões de Valores  
Organización Internacional de Comisiones de Valores  
المنظمة الدولية لبيانات الأوراق المالية

IOSCO Crypto-Asset Roadmap for 2022-2023

7 July 2022

<https://www.iosco.org/library/pubdocs/pdf/IOSCOPD705.pdf>

IOSCO publikoi më 7 korrik 2022 “Udhërrëfyesin e Crypto-Asset për 2022-2023” (*Crypto-Asset Roadmap for 2022-2023*) që përcakton agjendën rregullatore dhe planin e punës për sektorin për dy vitet e ardhshëm. Grupi i punës (Taskforca Fintech, FTF) e Bordit të IOSCO-s, e krijuar në mars të këtij viti, është mandatuar për të zhvilluar, mbikëqyrur, ofruar dhe zbatuar axhendën rregullatore të IOSCO-s për Fintech dhe krypto-asetet.

Grupi i punës, FTF, do t'i japë përparësi ndëtimimit të politikave lidhur me tregjet dhe aktivitetet e krypto-aseteve, ndërkohë që do të vazhdojë të monitorojë zhvillimet e tregjeve që lidhen gjerësisht me tendencat dhe inovacionin Fintech. FTF ka hartuar dy drejtime kryesore pune duke u fokusuar në Crypto e Asetet Dixhitale (CDA) dhe Financat e Decentralizuara (DeFi). Çdo njëri nga këto dy drejtime pune synon të publikojë një raport me rekomandimet e politikave deri në fund të vitit 2023. Interesi i investitorëve për asetet krypto u rrit me prezantimin e produkteve dhe tregjeve të reja lidhur me to, por ndërkohë trazirat e fundit të tregut kanë sjellë gjithashtu në humbje të konsiderueshme të investitorëve për shkak të pamjaftueshmërisë së masave rregullatore dhe mbrojtëse të tregut. Për këtë arsye, puna aktuale e FTF është kryesisht e fokusuar në analizimin dhe përgjigjen ndaj integritetit të tregut dhe shqetësimeve për mbrojtjen e investitorëve.

FTF po angazhohet me Bordin e Stabilitetit Financiar dhe punën e saj për të koordinuar çështjet që kanë të bëjnë me stabilitetin financiar, veçanërisht kur ato lidhen me IOSCO dhe mandatet e anëtarëve të saj të tregut të kapitalit.

Ashley Alder, Kryetar i IOSCO-s dhe Drejtues Ekzekutiv i Komisionit të Letrave me Vlerë të Hong Kongut, SFC tha: “Udhërrëfyesi ambicioz i IOSCO-s do të japë politikën globale të nevojshme për rregullatorët për të adresuar rreziqet e konsiderueshme që rrjedhin nga zhvillimi i shpejtë, kompleks dhe i turbullt të ekosistemit të asetëve krypto, duke ruajtur përfitimet shoqërore të inovacionit.”

Tuang Lee Lim, Asistenti i Drejtor Menaxhues për Tregjet e Kapitalit të Autoritetit Monetar të Singaporit, MAS dhe kryetari i FTF tha: “Natyra ndërkufitare e asetëve dhe tregjeve të kriptove kërkon një grup të fuqishëm rekomandimesh politikash për të mbështetur veprimet rregullatore të qëndrueshme dhe të koordinuara. Për realizimin e punës së saj, Task Forca Fintech IOSCO do të bashkëpunojë ngushtë me të tjerët organizmat e tjera ndërkombëtare për të adresuar fushat prioritare të integritetit të tregut dhe mbrojtjes së investitorëve, si edhe implikimet e tyre për stabilitetin financiar.



## BULLGARI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave zyrtare të publikuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë, FSC, tregu bullgar i sigurimeve arriti në 885.4 milionë BGN, ose rreth 452.7 milionë euro në fund të marsit 2022. Kjo shënon një rritje prej 9.7% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguresit e Jetës u rrit me 17.1% krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar, duke arritur në 175.5 milionë BGN, kryesisht i nxitur nga rritja pothuajse 20% e *Unit Link Products* (Policat e sigurimit të lidhura me skemat e investimeve), ndërsa vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguresit e Jo-Jetës u rrit me 8%, duke arritur në 710 milionë BGN.

## KROACI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas Autoritetit Kroat të Sigurimeve, në fund të qershorit 2022 tregu arriti në vlerën e 6.88 miliardë HRK, rreth 0.91 miliardë euro. Kjo vlerë shpreh një rritje prej 7.53% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Rritje të vëllimit të primeve të shkruara bruto, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, pati sektori i sigurimeve të Jo-Jetës që arriti vlerën e 5.34 miliardë HRK, me rritje 10.79% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Klasa më e njohur e sigurimeve është sigurimi i përgjegjësishë së pronarëve të mjeteve motorike, MTPL, që shënoi rritje prej 6.47% në vit. Pesha e kësaj klase në tregun total është 2.13% dhe në sektorin e sigurimeve të Jo-Jetës është 29.81%.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimeve të Jetës, në fund të qershorit 2022 arriti në 1.54 miliardë HRK, që tregon një rënie prej 2.77%. Sigurimi i Jetës në vitin 2022 përbën 22.40% të totalit të tregut. Në strukturën e sigurimeve të Jetës peshën më të madhe e zë sigurimi klasik i Jetës me vëllim të primeve të shkruara bruto në vlerën 1.11 miliardë HRK.

## MAQEDONI E VERIUT

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave paraprake të publikuara nga Agjencia lokale e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoninë e Veriut, në fund të marsit 2022, tregu i sigurimeve në vend arriti në 2.98 miliardë dinarë, afërsisht 48.37 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 11% në krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto të siguresve të Jo-Jetës u rrit me 9.5% duke arritur në 2.49 miliardë dinarë dhe që përbën mbi 83% të vëllimit total të primeve të shkruara bruto. Sigurimi i Jetës arriti në 494 milionë dinarë, duke shënuar një rritje prej 19.2% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## REPUBLIKA ÇEKE

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Shifrat e tremujorit të parë të vitit 2022 të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke, CNB tregojnë se industria vendase e sigurimeve arriti në rreth 2.1 miliardë euro, rreth 51.4 miliardë CZK. Kjo shifër shënon një rritje prej 15% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimet e Jetës u rritën me 4.8% duke arritur në 14.1 miliardë CZK. Ndërsa vlera e dëmeve të paguara, duke përfshirë edhe ndryshimin në bilancin e provigjoneve teknike, arriti në 11.6 miliardë CZK.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto të siguruesve të Jo-Jetës arriti në 37.3 miliardë CZK, duke shënuar një rritje me 19.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa vlera e dëmeve të paguara u rrit me rreth 40% në vit, duke arritur në 16.9 miliardë CZK.

## RUMANI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet bruto të shkruara nga kompanitë e sigurimeve në Rumani, në tremujorin e parë 2022, arritën pothuajse 4.66 miliardë lei, ose rreth 941.5 milionë euro. Kjo shifër është vlera më e lartë tremujore e regjistruar në historinë e tregut të sigurimeve në Rumani, duke u rritur me 46% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Të dy sektorët e tregut, si sigurimet e Jetës ashtu edhe ato të Jo-Jetës patën një rritje dyshifrore, por kontributi më i madh në rritjen e tregut erdhi nga sigurimet e Jo-Jetës, veçanërisht nga sigurimi MTPL, për të cilën vëllimi i primeve të shkruara bruto thuajse u dyfishua, në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2021.

Arsyeja kryesore e kësaj rritje lidhet me rritjen e vlerës mesatare të primit, prej afro 80% në vit. Kështu, vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimin MTPL arriti në 478.7 milionë euro, ndërsa vlera mesatare e primit arriti në 1,138 RON nga 632 RON një vit më parë. Vlera mesatare e dëmeve të paguar gjithashtu u rrit, por me një ritëm shumë më të ulët, me rreth 11%, duke arritur në 9,355 RON. Në përgjithësi, pagesat për dëmet nga sigurimet MTPL janë ulur me 16% në terma vjetorë, duke arritur në 154.3 milionë euro.

## SERBI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave të fundit të tremujorit të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, NBS, siguruesit në vend përfunduan tremujorin e parë të vitit 2022 me një vëllim total të primeve të shkruara bruto me vlerë 31.5 miliardë RSD, ose rreth 267.8 milionë euro.

Në të njëjtën kohë, gjatë kësaj periudhe pagesat e dëmeve nga siguruesit u rritën me 22% duke arritur në 14.2 miliardë dollarë, të nxitura nga rritjet dyshifrore të raportuara pothuajse në nënklasat e sigurimeve.

**Tendencat e tregut evropian****Sigurimi në Evropë: vëllimi i primeve të shkruara bruto për gjithë vitin 2021 e ka tejkaluar nivelin e vitit 2019 në shumicën e tregjeve**

Shifrat paraprake të vitit 2021 tregojnë se pas rihapjes ekonomitë e Evropës po shohin rritje në primet e sigurimit, megjithëse me shpejtësi të ndryshme, në vende të ndryshme. Në shumicën e tregjeve, vëllimi total i primeve u rrit krahasuar me vitin para pandemisë 2019. Raporti i “*Insurance Europe*” jep disa piketa kryesore të ecurisë:

- Në vitin 2021, sigurimi i Jetës arriti të rikthehet në nivelet "normale të rritjes së vëllimit të primeve të shkruara bruto. Produktet e sigurimit të Jetës të lidhura me skema kursimesh (*Unit Link Products*) udhëhoqën rritjen, por për të ardhmen e afërt, kombinimi i normave ende të ulëta të interesit dhe inflacioni i lartë mund të jetë sfidues për sigurimin e Jetës.
- Me rihapjen e ekonomive, edhe sigurimet e Jo-Jetës gjithashtu e rikuperuan rritjen e tyre. Shifrat paraprake tregojnë se tregje të ndryshme shënuan rritje pozitive, për vitin 2021 sidomos në primet e sigurimit të pronës. Por duke qenë se këto linja biznesi janë shumë të ekspozuara ndaj inflacionit, rritja mund të jetë rezultat i rritjes së kostos së mallrave dhe shërbimeve që tashmë kanë filluar të ndikojnë në primet.
- Dëmet e paguara për sigurimet motorike patën tendenca të ndryshme zhvillimi. Rritja e dëmeve të paguara ishte kryesisht rezultat i rritjes së dëmeve të paguara për kostot më të larta për shpenzimet motorike. Pagesat e dëmeve shëndetësore nga kontratat e MTPL gjithashtu u rritën në shumicën e vendeve, si një prirje ardhur kryesisht nga vonesat e trajtimeve mjekësore gjatë vitit 2021. Sa i përket sigurimit të pronës, përveç rritjeve të lidhura me kontrata personale e tregtare në sigurimin e pronës, rritja e pagesave të dëmeve u lidh shumë me pasojat e klimës, si përmbytjet e stuhitë, të cilat sollën rekorde të reja në disa tregje.

Shqetësimi kryesor për të ardhmen e afërt lidhet me inflacionin e lartë, i cili pritet të vazhdojë të sfidojë siguruesit evropianë. Sipas autorëve të raportit të “*Insurance Europe*”, inflacioni i lartë do të shkaktojë kosto më të larta për dëmet e paguara, të cilat do të reflektohen në prime më të larta. Nga ana tjetër, inflacioni i lartë pritet të ndikojë edhe në aftësinë e shumë njerëzve për të blerë produkte dhe shërbime të caktuara, duke ndikuar ndoshta në aftësinë e tyre për të kursyer. Një tendencë pozitive mund të lindë nga rritja e normave të interesit, e cila është pozitive për sektorin e sigurimeve të Jetës.



---

---

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)